



**INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE**

---

## **RREGULLORJA E BRENDSHME E BORDIT DREJTUES**

Shtator 2020

*Instituti i Studimeve Politike (ISP), organizatë jofitimprurëse, regjistruar sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë, themeluar në datën 27. 03. 2006 me Vendim 397 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT L41421452C me adresë: Rruga "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89, K.3, Ap 16 A, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Afrim Krasniqi.*

## **QËLLIMI I RREGULLORES SË BRENDSHME**

Rregullorja e brendshme përmban rregulla të shkruara të rëndësishme, që shërbejnë për drejtimin e Institutit të Studimeve Politike (ISP).

Kjo rregullore e brendshme:

- përcakton ndarjen e përgjegjësive
- rregullon mënyrën se si e realizon ISP misionin e tij;
- mundëson ISP të marrë vendime të reja;
- ndihmon ISP të përballojë sfida të reja;
- ndihmon ISP t'i përshtatet ndryshimeve të brendshme në qendër;
- siguron drejtësinë e vendimeve të Bordit dhe mbrojtjen kundër akuzave ligjore.

Rregullorja e brendshme mund të zgjerohet me amendamente të tjera sipas nevojës, dhe kryen tre funksione kryesore:

1. Përcakton strukturën dhe detyrat e drejtuesve të Bordit dhe anëtarëve të tij.
2. Përcakton të drejtat e pjesëmarrësve në strukturë, siç janë të drejtat e anëtarëve lidhur me njoftimin paraprak për mbledhjet e Bordit, largimin e tyre nga detyra, etj.
3. Përcakton procedurat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të anëtarëve të Bordit, formën e caktuar për njoftimet e mbledhjeve, etj.

## **Neni 1**

### **Emri dhe Vendndodhja**

Qendra "Instituti i Studimeve Politike" është një organizatë jo fitimprurëse që synon të kontribuojë në fuqizimin e rolit të qytetarit në shoqëri nëpërmjet advokimit të politikave, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes qytetare dhe zhvillimit të kapaciteteve të grupeve komunitare për një qeverisje të mirë.

Selia e organizatës është në Tiranë, Rruga "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89, K.3, Ap 16 A.

## **Neni 2**

### **Qëllimi i Rregullores**

Kjo rregullore, mbështetur në Statutin e ISP, përcakton dispozitat kryesore që rregullojnë veprimtarinë dhe jetën e brendshme të Bordit.

## **Neni 3**

### **Mbledhjet e Bordit**

Bordi i ISP mbledhet të paktën 4 (katër) herë në vit për çështje të zakonshme që kanë të bëjnë me aktivitetin e ISP dhe thirret nga Drejtori Ekzekutiv. Rendi i ditës së këtyre mbledhjeve përcaktohet nga drejtori dhe duhet të përfshijë të paktën pikat e mëposhtme:

- a. Miratimin e shënimeve të mbledhjes së mëparshme;
- b. Raportime nga drejtori ekzekutiv, financieri dhe/ose departamentet.
- c. Vendime të tjera në varësi nga prioritetet dhe nevojat e ISP.

Bordi mund të thirret në mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesë të 1/3 e anëtarëve të Bordit. Vendimet e mbledhjes së Bordit konsiderohen të vlefshme kur merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Vendimet për ndryshimin e Statutit, Aktit të Themelimit apo miratimin e rregulloreve të brendshme merren me 2/3 e votave të anëtarëve.

Asnjë nga dispozitat e mëposhtme nuk duhet të interpretohet si fakt që pengon anëtarët e Bordit të kundërshtojnë njoftimin apo të mos marrin pjesë në mbledhje. Në qoftë se nuk parashikohet ndryshe në Statutin e ISP dhe në këtë Rregullore, të gjitha mbledhjet e ISP, të Bordit dhe të Departamenteve të saj duhet të drejtohen sipas rregullave të zakonshme të mbledhjeve.

## **Neni 4**

### **Bordi Drejtues**

Bordi Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga themeluesit e ISP, me mandat 4 vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje. Personi Juridik përfaqësohet në Bord prej përfaqësuesit ligjor të tij. Anëtarët e Bordit duhet të jenë mbi 18 vjeç dhe duhet të kenë dëshirë që të dedikojnë kohë dhe përpjekje për të kryer përgjegjësitë ndaj Bordit.

## **Neni 5**

### **Detyrat dhe zgjedhja e strukturave të Bordit Drejtues**

Bordi Drejtues drejton dhe kontrollon veprimtarinë e ISP. Përgjegjësitë kryesore të Bordit janë:

- Përcakton programin e veprimtarisë së ISP;
- Shqyrton çështjet ekonomike;

- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë;
- Emëron/zgjedh Drejtorin Ekzekutiv;
- Krijon Departament e posaçme dhe pozicionet administrative.

Bordi Drejtues zhvillon veprimtarinë bazuar në Statutin e ISP si dhe në Rregulloren e Brendshme të Bordit.

## **Neni 6 Pjesëmarrja**

Kuorumi për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit bëhet me pjesëmarrjen e minimalisht shumicës së anëtarëve të Bordit. Çdo anëtar Bordi, me katër mungesa të njëpasnjëshme, pa ndonjë arsye, njoftohet nga Drejtuesi i Mbledhjes së radhës për shkarkimin e tij nga detyra si anëtar Bordi, dhe propozohet zëvendësimi i tij nga Bordi.

## **Neni 7 Drejtuesit e Bordit**

Bordi drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv i cili zgjidhet nga anëtarësia e Bordit me shumicë të thjeshtë votash për një mandat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Drejtori organizon dhe drejton mbledhjen e radhës dhe kryen përgjegjësitë e zakonshme të një Drejtuesi (*shih në seksionin e Drejtuesit të Bordit*), të cilat nuk janë në kundërshtim me kompetencat dhe qëllimet e organizatës, të përcaktuara në Statutin e saj.

Drejtori Ekzekutiv siguron që për Bordin është përgatitur një buxhet vjetor, të cilin ia paraqet Bordit një herë në vit ose më shpesh kur i kërkohet nga Bordi. Në mbledhjen vjetore të Bordit ai paraqet raportin përfundimtar vjetor dhe financiar.

Të gjitha dokumentet e mbledhjeve të Bordit duhet të mbahen për një periudhë kohe që përputhet me kërkesat profesionale, administrative dhe ligjore të rregullave dhe ligjeve në fuqi të shtetit.

## **Neni 8 Departament e Përkohshëm të Bordit**

Bordi Drejtues sipas nevojave të ISP ka kompetencën të formojë dhe të shkrijë departamente të përkohshme ose degë lokale në funksion të qëllimeve dhe aktivitetit të organizatës. Anëtarët e Bordit mund të jenë pjesëtarë të departamenteve dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e njëherësh, dy prej strukturave të tilla. Departamentet nuk kufizohen në emërtim dhe nevojë por ISP ka prioritet departamentin e programeve, të legjislacionit dhe vlerësimit; të financës dhe të marrëdhënieve me publikun, etj. ISP synon të ketë degë të përhershme koordinuese në qendrat kryesore të qarqeve.

**Neni 9**  
**Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Drejtues**

Anëtarët e Bordit Drejtues nuk shpërblehen për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Bordit, por mund t'iu mbulohen vetëm shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen në mbledhje në rastet kur pjesëmarrja sjell shpenzime. Anëtarët e Bordit mund të marrin shpërblim vetëm për detyra të kryera tërësisht në funksion të veprimtarisë dhe në emër të ISP.

**Neni 10**  
**Konflikti i Interesave**

Anëtarët e Bordit dhe Drejtori Ekzekutiv lejohen të angazhohen si ekspert në aktivitete apo transaksione që lidhen me natyrën dhe qëllimin e organizatës edhe gjatë kohës që janë në detyrë. Kjo vetëm për rastet kur cilësia dhe profesionaliteti i anëtarit të bordit ofron cilësinë më të lartë të ekspertizës në projekt. Çdo lloj dualiteti interesash apo konflikti i interesave i duhet bërë i ditur anëtarëve të tjerë të Bordit dhe të ketë një vendim për lejimin në çdo rast nga Bordi. Shenimet e mbledhjes duhet të pasqyrojnë vendimin/vendimet, projektin/projektet si dhe t'u bëhet e ditur palëve të treta, nëse kërkohet.

**Neni 11**  
**Amendamentet e Rregullores së Brendshme**

Amendamentet e propozuara i dorëzohen me shkrim anëtarëve të Bordit. Këto amendamente shpërndahen dhe lexohen në dy mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit. Amendamentet e propozuara njoftohen me shkrim përpara secilës mbledhje. Për aprovimin e këtyre amendamenteve kërkohet 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm. (shih në seksionin e kuorumit).

**Neni 12**  
**Shkrirja**

Në rast se ISP shkrihet dhe aktiviteti i saj përfundon, e drejta e pronësisë mbi pjesën e pasurisë së mbetur pas shlyerjes së borxheve të ISP, nëse ka të tilla, i kalon organizatave me mision të ngjashëm, e aprovuar nga Bordi, në praninë e kuorumit.

**Neni 13**  
**Departamentet dhe koordinatorët lokalë**

Departamentet dhe koordinatorët lokalë të ISP miratohen nga Bordi me propozimin e drejtorit ekzekutiv dhe të secilit prej anëtarëve themelues të Qendrës. Krijimi dhe

organizimi i tyre bëhet në përputhje me nevojat, prioritetet dhe strategjinë e ISP dhe në funksion edhe të projekteve ku organizata është e angazhuar për një periudhë më të gjatë sesa 3 vjetecare.

Departamentet kanë rol aktiv për të hartuar programin e ISP në përputhje me objektivat e saj dhe legjislacionin në fuqi; për t'i rekomanduar anëtarë Bordit të ISP; për të marrë vendime në bashkëpunim me Drejtorit Ekzekutiv sipas kësaj Rregulloreje, me përjashtim të kufizimeve të përshkruara më poshtë. Ato mund t'i propozojnë Bordit, procedura dhe masa për mbikëqyrjen, disiplinimin deri edhe në shkarkimin e drejtorit ekzekutiv.

Departamenti i financës ka nën kontroll hartimin e buxhetit, monitorimin e shpenzimeve, siguron kontrollin e duhur financiar dhe bën rishikimin e granteve kryesore. Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun përfaqëson ISP-në në publik, zgjeron imazhin e saj duke përfshirë edhe komunikimin me median. Bordi mund të caktojë herë pas here departamente dhe koordinatorë për t'i shërbyer qëllimeve të ISP, në ato raste kur gjykohet se është e nevojshme prej tij.

Në përputhje me dispozita të tjera të kësaj rregulloreje, çdo departament i caktuar nga Bordi: (a) i nënshtrohet kufizimeve të vendosura nga Bordi, nga kjo Rregullore e Brendshme, nga Statuti apo ligji përkatës; (b) Mban shënime të rregullta të mbledhjeve dhe duhet t'i paraqesë ato në mbledhjet e Bordit. Në rast se Bordi nuk krijon ndonjë nga departament e përmendura më lart këtë funksion e kryen vetë Bordi.

#### **Neni 14**

#### **Dokumentet dhe Regjistrat e Llogarisë**

Në përputhje me Rregulloren e Menaxhimit Financuar, ISP mban libra dhe regjistra të rregullt llogarie, shënime të mbledhjeve të anëtarëve të Bordit dhe departamenteve të tij, si dhe duhet të mbajë në zyrën e ISP një regjistër me emrat dhe adresat e anëtarëve me të drejtë vote dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm. Të gjitha dokumentet dhe regjistrat e ISP mund të inspektohen nga çdo anëtar i rregullt, sipas procedurave të miratuara nga Bordi.

*Miraturar me vendim të Bordit Drejtues, nr. 9/1, datë 21.09.2020.*